

“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 Mobile : • E-mail: pronesi_me_drejtësi@yahoo.com

TRUPIT DIPLOMATOIK TE AKREDITUAR NE SHQIPERI:

AMBASADES SE GJERMANISE

SHKELQESIA JUAJ ZNJ. AMBASADORE.

Në emër të pronarëve të Shpronësuar nga diktatura, në vijim të shumë ankesave të tjera të mëparshme, ju transmetojme reagimin tonë , pergjigje ndaj pendeses publike te ish kryeministrit z. Pndeli Majko që është publikuar dt 5.109.2012 në gazetat “Sot” dhe “Zëri Popullit” **Ju lutemi te shpreheni publikisht qendrimin e Gjermanise per këtë problem themelor, që përcakton hyrjen në demokraci dhe kerkon solidarizimin ndihmen dhe lobingun tuaj .**

Me respekt

Rrapo Hajredin Danushi


Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”

Tirane, me 5 Shtator 2012.

Është detyrim moral ta falenderojmë publikisht deputetin Pandeli Majko si edhe redaksitë që publikuan reflektimin e tij “Prona - krimi kolektiv i politikës për vota dhe pushtet” , e botuar me datë 1 Shtator, 2012 në gazetat Tema, Metropol, Zëri i Popullit, Koha Jonë, Panorama, Republika, etj. E vlerësojmë pohimin e saktë z. Pandeli Majko për faktin se kjo figurë prezente e politikës pohon qartë që në këtë krim kolektiv të politikës, për çështjen e pronës sjellja e shtetit shqiptar bie ndesh me Kushtetutën, se kompensimi është ëndërr e bukur, përdor termin pronar dhe jo termin ish pronar që pëlqejnë të përdorin vjedhësit e pronave etj. Por cilët janë emrat dhe autorët që kanë përgjegjësi për këtë rrugë kriminale dhe bilanc luftime me të vrarë që vazhdojnë të shtohen Në krijimin e katrahurës me pronat, Sali Berisha ka përgjegjësinë kryesore. Ai është si numri një dhe pas tij renditen zerot, që janë të gjithë presidentët e pas vitit 1991, të gjithë kryetarët e Kuvendit, Banka Botërore, FMN-ja, USAID-i, disa nga ambasadorët që kanë financuar me fonde, projekte dhe mbështetje morale dhe të gjithë deputetët (kuptohet përjashto z. Abdi Baleta dhe ata që janë përpjekur dhe janë distancuar). Për më keq, Banka Botërore fton që Shoqata të pranojë rekomandimet e gatuar prej saj për platformën e zgjidhjes së problemit të pronës, kur në zbatim të parimeve të kartës së Helsinkit dhe të Kopenhagenit, ata duhet t’a bllokojnë këtë shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

Të gjithë ata që e kanë lexuar në internet apo në gazeta apelin e z. Agim Hamiti që, me shumë patriotizëm, i drejtohet klasës politike shqiptare dhe ambasadorëve, impresionohen nga faktet që z. Agim Hamiti paraqit por më shumë të impresionon fakti se politikanët nuk kanë pasur forcën morale që të reagojë dhe ta kundërshtojë atë me debat publik.

Shoqata jone me kohë e ka të përgatitur platformën dhe projektligjin perkates per zgjidhjen e anarkisë me pronën që do të respektoje të drejtën e pronësisë në përputhje me kerkesat e kushtetutës dhe kërkesat e KE-se dhe BE-se dhe pa kosto ose me kosto minimale dhe që do të sillte barazine, zhvillimin ekonomik dhe do ta çlironte vendin nga makthi makaber i kaq shumë problemeve që ka kapërthyer vendin për mbi dy dekada – kjo eshte zgjidhja e nyjes



“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice


P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 Mobile : • E-mail: pronesi_me_drejttesi@yahoo.com

gordiane për ecjen e vendit ne rrugen normale te demokracise. Prandaj dëshirojmë që ky qëndrim i deputetit Pandeli Majko të jetë reflektim për të gjithë deputetët, politikanët dhe ambasadorët, që edhe ata të bëhen mbrojtës dhe jo shkelës të Kushtetutës.

Ne shumë herë kemi përsëritur publikisht se në Shqipëri ka pseudodemokraci dhe nuk ka sistem drejtësie por autokraci me disa elementë të çrregullt të privatizimit të përzier me korrupsion. Padrejtësia arrin pikën kulminante kur përmbarimi (shteti) nuk ekzekuton vendimet e gjykatave të formës së prerë. Janë bërë publike edhe vendime të Gjykatës së Strasburgut që akoma nuk janë ekzekutuar dhe Avokati i Shtetit i raporton Këshillit të Europës se ato janë ekzekutuar. Kjo është kryefjala për Presidentin e Republikës që është garanti i Kushtetutës dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe për këto duhet të bëjë debat të ashpër opozita. Politika 20 vjeçare e Sali Berishës bëri që prona e shtetëzuar nga regjimi diktatorial i Enverit si dhe pronat që para 1945 i përkasin shtetit, të trajtohen si prona në dispozicion të Qeverisë. Kjo platformë që filloi me “terapinë e shokut” dhe “cekun e bardhë” i ka pëlqyer deputetëve të majtë dhe të djathtë të cilët e kanë shfrytëzuar qenien në politikë për t’u pasuruar dhe zoti Pandeli Majko ka shumë të drejtë kur deklaron publikisht se “prona është krim kolektiv i politikës për vota dhe pushtet”. Shtypi çdo javë njofton krime të reja për shkak të pronës. Ndërkombëtarët konstatojnë por nuk veprojnë, në mënyrë efektive. Dihet se Presidenti i Egypetit Hosni Mubarak u detyrua të braktiste postin prej qëndrimit unanimit kundër tij të diplomacisë amerikano-evropiane pasi vrau 300 shtetas në një popull 80 milionësh për shkak të çmendurisë së tij për post. Nëse numri i viktimave ne Egjipt perkthehet ne raport proporcional me popullatën e Shqipërisë ai do te ishte 15 viktima nderkohe qe ne Shqiperi realisht ka bilanc lufte me të vrarë dhe mijëra familje të ngujuara per shkak te prones. Kujt i intereson që ndërkombëtarët megjithese e konstatojnë anarkinë 20 vjeçare të pronës, që në Shqipëri ka shkaktuar një bilanc lufte, jo vetëm heshtin por dhe e financojnë atë?! Kjo politikë që bie ndesh me parimet e politikës së Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe NATO-s, vazhdon të jetë një fakt i pamohueshëm.

Shoqata “Pronësi me drejtësi” që në vitin 1991 ka argumentuar se qëndrimi i Sali Berishës është anktikombëtar por po përmendim vetëm ato më të fundit botuar ne gazetën Zeri i Popullit me 18.02.2011, gazetën Sot me 20.02.2011, gazetën Shekulli me 21.02.2011, gazetën Telegraf më 22.12.2011, Zeri i Popullit me 31.03.2012 si edhe kritikën publike për platformën e qeverisë të mbështetur prej Bankës Botërore publikuar në gazetat Sot, Shekulli, Metropol, Zeri i Popullit, Dielli, Mapo, etj. Në Apelin Publik tonin dërguar ambasadorëve Aleksandër Arvizu, Ettore Sequi dhe Eugen Wollfarth, te botuar me 8.02.2011 në gazetat Tema, Zeri i Popullit, Sot, Shekulli, ne denoncuam per te disaten here duke thene se kur shteti nuk kthen pronën tek i zoti nuk ka demokraci funksionale. Pronat që diktatura i shtetëzoi, pas vitit 1991, së bashku me pronat që ligjërisht i përkasin shtetit vazhdojnë të përvetësohen nga politikanët .Ky është produkti Berisha. Prona dhe jo tek imuniteti është thelbi i korrupsionit dhe i konfliktit të ashpër midis klaneve të politikës që po e vret popullin por dhe po shpërbën Shqipërinë. Prandaj Sali Berishën në denoncimet e mëparshme e kam krahasuar me një personazh të mirënjohur me emrin Ali Baba me 40 hajdutë. Në atë shkrim, me keqardhje kemi protestuar edhe kundër ish ambasadorëve të SHBA-se William E. Rayerson dhe John Withers II, ambasadorit te OSBE-se Osmo Lipponen, ambasadorit të BE-së Helmuth Lohan dhe përfaqesuesve te Bankës Botërore e FMN-se, të cilët me qëndrimet e tyre indiferente ndaj ankesave tona për shkeljen sistematike të së drejtës



“PRONËSI ME DREJTËSI” NATIONAL ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 33 22 4883 Mobile : • E-mail: pronesi_me_drejttesi@yahoo.com

së pronës (me justifikimin e mos ndërhyrjes !!), kanë bërë që në Shqipëri korrupsioni për pronat të kultivohet në nivel institucional.

Situata e anarkisë së pronës dhe e standardeve të dyfishta e parë më thellë, nuk është vetëm lufta pa princip për pasuri për vota dhe pushtet. Qëndrimi konseguent i Sali Berishës në mbrojtjen me ligj të personave që përvetësojnë prona që janë të dikuj tjetër, ka kultivuar në popull anën e dobëta, vesin e vjedhjes, të imoralitetit. Edhe sa kohë do vazhdojë kjo politikë e verbër?!Pse kjo politikë, vazhdon të mbështetet nga përfaqësuesit e Bankës Botërore. Moralisht vjedhja e pronës është e ndaluar, ose haram. Përvetësimi qoftë dhe i një pëllëmbë tokë konsiderohet si faji më i rëndë pas atij të mohimit të Zotit dhe moralisht ka dënimin e dytë më të rëndë. Politikanët që nuk do heqin dorë nga qëndrimi antipronar, nga standardet e dyfishta dhe zgjidhjet e tipit fillucka sapuni me kompensimin, legalizimin, kalimin nga përdorimi në pronësi të oborreve etj., ecin në rrugën që e fut Shqipërinë në kriza pas krizash me rezultat prishjen e identitetit kombëtar dhe e nxjerr Shqipërinë në treg. Kjo politikë bie ndesh edhe me vendimin pilot të Strasburgut. Këta politikanë historia do ti shënojë në listën e zezë të tradhëtareve të kombit! Prandaj ju bejme thirrje të gjithëve që ju dhimbset sadopak Shqipëria, atyre politikaneve që thjesht nuk duan të hidhen në koshin e historisë, apo atyre përfaqësuesve të kancelarive të huaja dhe organizmave ndërkombëtare që duan më shumë se sa të jenë thjesht rrogëtarë por dhe misionarë të të drejtave të njeriut dhe parimeve demokratike dhe të bëjnë diferencën në jetën e një populli e të nderohen në historinë e tij, të veprojnë sa nuk është vonë!

Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve

“Pronësi me Drejtësi”